



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 143, datë 30.07.2018

PËR

MIRATIMIN E PROSPEKTIT DHE FONDIT TË INVESTIMIT
“RAIFFEISEN VIZION”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të neneve 54, 55, 73 dhe 74, të Ligjit nr. 10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjen e investimeve kolektive”, i ndryshuar, me propozim të Zyrës së Licencimit, Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e prospektit të fondit të investimit “Raiffeisen Vizion”, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Miratimin e krijimit të fondit të investimit “Raiffeisen Vizion” e administruar nga shoqëria administruese “Raiffeisen Invest” sh.a.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI